

# Pupu ka një ide!



**Për klasën e pestë të arsimit fillor**



# Pupu ka një ide!

## **Fjalët kyçe:**

projekt, ndërmarrësia, ndërmarrja, ndërmarrja financiare, buxheti grupor, fitimi, investimi.

## **Udhëzime për punë me librin.**

### **Para leximit: Bisedë me fëmijët:**

- Tregoni një shembull kur keni organizuar me klasën një projekt fitimprurës?
- Ideja e kujt ka qenë për projekt?
- Cili ishte qëllimi i projektit tuaj?

### **Gjatë leximit: Bisedë me fëmijët:**

- Nxitni fëmijët të flasin për atë çfarë shohin në ilustrim.
- Përdorni pyetjet: Çfarë po shihni? Pse është....? Ku ...? etj.
- Pas çdo faqeje të lexuar bisedoni për atë se çfarë ka ndodhur.
- Nxitni fëmijët të parashikojnë se çfarë do të ndodhë në faqen tjetër pa e shfletuar ende.
- Kërkoni nga fëmijët që të gjejnë fjalë të ngjashme me disa nga fjalët e reja në tekst.

### **Pas leximit: Bisedë me fëmijët:**

- Shihni faqet 4 dhe 5: Çfarë po ndodhte në klasën e Pupos?
- Shihni faqet 6 dhe 7: Cila ishte ideja e Pupos?
- Shihni faqet 8 dhe 9: Cilat këshilla i morën fëmijët nga xha Tomi?
- Shihni faqet 10 dhe 11: Përse doli i suksesshëm projekti i ndërmarrjes financiare?
- Planifikoni një projekt me klasën duke planifikuar qëllimin dhe buxhetin detajisht.


# Yjësia

Yjet lindin, jetojnë dhe shuhen, - tha mësuesja derisa Pupu dhe nxënësit tjerë po e dëgjonin me vëmendje shpjegimin e saj.



4





- Sa bukuuur!!! Unë mund ta prek yllin me dorë, - fliste Lira si e magjepsur nga ajo çfarë po shihte duke e zgjatur dorën sikur vërtet donte ta prekte yllin.

Pupun nuk e zinte vendi vend derisa po priste radhën e tij për të shikuar me teleskop. Ai po zgjatej pas krahëve të Lirës, herë djathtas herë majtas, por më kot, nuk mund të shihte asgjë. Durimit të tij po i vinte fundi.

- Mësuese, tani e kam radhën unë,- u dëgjua zëri ankues i Pupu.

- Sigurisht Pupu! Eja,- e thirri mësuesja.

Derisa mësuesja po e rregullonte qartësinë e thjerrëzës, teleskopi rrëshqiti nga tavolina dhe ra në dysheme duke u shpërndarë në mijëra copëza qelqi.

- Oh jo, teleskopit iu dëmtua thjerrëza,- thirri mësuesja e mërzhitur. - Si do t'ia bëjmë tani pa teleskop? Shkolla nuk ka teleskop tjetër, - tha ajo duke i mbledhur copëzat e qelqit.



**U dëgjua zilja dhe ora përfundoi. Të gjithë po mendonin si do t'ia bëjnë tani? Papritmas u dëgjua zëri i Pupus i cili doli para klasës dhe ngriti dorën lart.**

**- Unë kam një ide! - foli Pupu. - Le të fitojmë të holla dhe të sigurojmë një teleskop të ri, - propozoi ai shpejt.**

**Të gjithë tunden kokën në shenjë pajtimi dhe fytyra iu buzëqeshi.**


**- Mësueses do t'ia bëjmë befasi, ajo nuk duhet të dijë asgjë - foli me zë të ulët Pupu.**



- Buxheti i klasës është i planifikuar për gjëra tjera. Kemi pak të holla të ndara për raste urgjente por nuk mjaftojnë për të blerë teleskopin, - foli me dyshim Lira, arkëtarja e klasës.
- Le të takohemi pas mësimit, rreth orës pesë, në bibliotekën e shkollës dhe të shpalojmë idetë tona. Do të mendojmë ndonjë projekt fitimprurës, - shtoi Timi.
- Lira merre me vete librin e kursimeve të shohim si qëndrojmë me para, - ia kujtoi Pupu.







**Ashtu dhe u bë. Në orën pesë u hapën dyert e bibliotekës së shkollës. Erdhën pothuajse të gjithë. Në fund erdhi edhe Lira e shoqëruar me babain e saj.**

**- Babi im është një ndërmarrës i suksesshëm. E ftova që të na ndihmojë, pasi që është hera e parë që do të bëjmë një projekt ndërmarrësie, - u arsyetua Lira.**

**- Bravo Lira! Kemi nevojë për një profesionist. Mirë se erdhe xha Tomi, - tha Pupu.**

**Xha Tomi dëgjoji me kujdes qëllimin dhe idetë e fëmijëve që vendoseshin në tabelë. I lavdëroi për iniciativën e përbashkët që po ndërmernin si dhe idetë që i shpalosën.**

**- Po shoh se ju duhet një projekt i mirë për t'i siguruar paratë e nevojshme. Kjo do të thotë se aktivitetet që do të ndërmerni kushtojnë, andaj duhet ta planifikoni me saktësi, investimet që do të bëni si dhe fitimet që pritni t'i realizoni. Mos harroni, pa bashkëpunim nuk mund të arrini asgjë! - i këshilloi ai.**






**Filloi shpalosja e mendimeve. Nga të gjitha idetë e propozuara, u përzgjedhën me votim ato që u mendua se do të jenë më fitimprurëse. Pupu lexoi listën e aktiviteteve dhe udhëheqësit e tyre.**

**- Aktivitetin e ngasjes së biçikletës do ta udhëheqë Sara, aktivitetin për punimin e librave të vegjël do ta udhëheqë Timi, kurse atë të kodimit të robotit lodër do ta udhëheqë unë,- tha Pupu.**

**- Përveç që do ta blej materialin e nevojshëm, unë do të kujdesem për fotografimin e fëmijëve me aktivitetet që bëjnë, - shtoi Lira.**

**Të gjithë u ndien të lumtur për punën që do të bënin.**





Pas një jave të gjithë ishin gati të fillojnë me aktivitetet. E tërë klasa e Pupu ishte aty që t'iu dilte në ndihmë. Ata kishin punuar vullnetarisht fletëpalosje dhe i kishin shpërndarë ato në tërë shkollën e tyre duke i njoftuar që gjatë muajit tetor, çdo të shtunë do të mbahen aktivitete të ndryshme për fëmijët në oborrin e shkollës.

Lea, Timi, Sara dhe Pupu kishin veshur fanelat me mbishkrimin “Unë kam një ide!!!”. Secili qëndronte para banakut të vet.

- Oh jo, mësuesja na paska zbuluar, - i përshpëriti Lirës Pupu, duke shikuar mësuesen tek po bisedonte me Sarën dhe Timin.



- Pupu, kam dëgjuar për projektin tuaj. Jam shumë krenare me ju, - i tha ajo me buzëqeshje në fytyrë.  
Pupu u ndje i çliruar. Papritmas ai dëgjoji zërin e një vogëlusheje.  
- Mua më pëlqejnë robotët, dua të mësoj t'i lëvizë,- foli ajo me zë të qetë.





**SHKOLLA**

**Pasi i mësoi vajzës kodimin e robotit, ajo bëri provën e parë dhe ja roboti filloi ta përshëndeste vajzën me ngritje të dorës.**

**- Urraaa, ia dola, - thirri gjithë gëzim vajza derisa po shikonte robotin duke e përshëndetur.**

**Pupu ishte krenar për punën e bërë por edhe për pagesën që ia bëri babai i vogëlushes.**



Lira po fotografonte çdo pjesëmarrës dhe ata po e paguanin për këtë.

- Nëse vazhdojmë kështu edhe tri të shtuna tjera, ne do t'i sigurojmë paratë e duhura për t'i mbuluar jo vetëm shpenzimet e bëra por edhe blerjen e teleskopit të ri, - foli bindshëm Lira.

Shumë shpejt, e shtuna e katërt e tetorit u afhua. Të gjithë ishin pak të shqetësuar se a do t'ia dilnin të mbledhnin shumën e nevojshme të parave.

Në fund të ditës, Lira bëri llogarinë. E ngriti kokën lartë dhe i shikoi fytyrat e shokëve dhe shoqeve të klasës që po prisnin përgjigjen nga ajo.

- Ne.... - pushoi Lira pak për të vazhduar përsëri, - ne ...ia dolëm, kemi fituar më shumë para se që na nevojiteshin, - thirri ajo me zë të lartë.

- Urraaaa, - thirrën të tjerët duke kërcyer nga gëzimi.




22 NËNTORI  
- DITA BOTËRORE  
E NDËRMARRËSISË

*Junior*







**Në Ditën Botërore të Ndërmarrësisë, klasa e Pupus ishte përzgjedhur si mysafire speciale për të shpalosur punën e tyre. Në panair ishin të pranishëm udhëheqës të pozitivave të ndryshme në qytet si dhe ndërmarrës të ndryshëm financiar. Aty ishin edhe prindërit e tyre dhe shumë shokë e shoqe të shkollës. Ata panë shembuj të ndryshëm të udhëheqjes së ndërmarrësisë së suksesshme. Klasa u shpërblye me mirënjohje për ndërmarrës të ardhshëm junior.**



**Fëmijët ishin shumë krenarë me suksesin e arritur.**

- Ne edhe fituam para por edhe mësuam si të udhëheqim një ndërmarrje.
  - Tani e di se kur të rritem, unë do të bëhem ndërmarrëse e një biznesi të vogël,- tha Sara.
  - Duhet të mendojmë edhe një ide për një ndërmarrje tjetër, që të sigurojmë një shëtitje në fund të klasës së pestë.
  - Sa mirë që u prish thjerrëza e teleskopit atë ditë, sepse ne mësuam shumë gjëra, – tha Pupu.
- Sapo dëgjuan këtë, të gjithë ia shkrepën të qeshurës.**



Titulli: "Pupu ka një ide!"  
Hartoi tekstin: Luljeta Rama  
Ilustroi: Leopard Cana

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

0875  
821.18-93-34  
Rama, Luljeta  
Pupu ka një ide!/ hartoi tekstin Luljeta Rama; ilustroi Leopard Cana. - Prishtinë:  
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, 2020. - 20 f. : ilustr. ; 22 cm. - (Libri i pestë)  
1.Cana, Leopard  
ISBN 978-9951-8977-8-5

E drejta e autorit i përket Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nëse përdorni pjesë të këtij botimi, ju lutemi të citoni burimin.  
Realizimi i këtij libri u mbështet nga EFSE Departamenti për Zhvillim.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Adresa: Rr. Garibaldi, Nr. 33 Prishtinë, Kosovë.  
Tel: + 383 38 222 055  
Fax: +383 38 243 763  
e-mail: [info@bqk-kos.org](mailto:info@bqk-kos.org)



# Pupu ka një ide!

**Pupu në garën e vrapimit**

**Pupu shkon në bankë!**

**A do të shkojë Pupu në cirk?**

**Një ditëlindje më ndryshe!**

**Pupu ka një ide!**

**Libri i pestë**

[www.edukimifinanciar.org](http://www.edukimifinanciar.org)

Edukimi financiar për nxënësit e klasave I-V

ISBN 978-9951-8977-8-5



9 789951 897785